

VENDIM
Nr.333, datë 1.4.2009

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1322, DATË 1.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA
AUTORITETI PORTUAL, DURRËS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS TË
KINOKLUBIT “MUJO ULQINAKU”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.586, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME
DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 10, 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1322, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 të këtij vendimi, pas togfjalëshit “...Mujo Ulqinaku...” shtohen fjalët “...përfshirë truallin nën godinë dhe përreth saj me sipërfaqe të përgjithshme 2 479 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) m²...”.

2. Në pikën 2 të këtij vendimi, pas fjalëve “...me numër rendor 21...”, shtohen “... dhe për sipërfaqen 2 479 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) m² nga sipërfaqja e përgjithshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha